



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 27

Prishtinë, më 30.3. 2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Fadil Demaku, nënkryetar i parë; Bojan Mitiq, nënkryetar i dytë, Anton Quni, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami dhe Nuredin Ibishi, anëtarë.

Munguan: Daut Haradinaj, Rexhep Selimi dhe Zafir Berisha.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Pjesëmarrës të tjerë: Blend Zyrapi-KIPRED; Bardhë Xhoi; Plator Abvdiu-QKSS; Genci Jaha-KDI dhe Dhurata Kryeziu-OSBE.

Mbledhjen e kryesoi, Fadil Demaku, nënkryetar i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 09.03.2016;
3. Adresimi i sfidave që dalin nga raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2015 dhe nga Plani Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 9. 3. 2016

Procesverbalet u miratuan pa vërejtje.

3. Adresimi i sfidave që dalin nga Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2015 dhe nga Plani Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit.

Kryesuesi- Theksoi se përmes kësaj pike qëllimi është që të adresohen sfidat që dalin nga Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2015, ku i referohet mbikëqyrjes demokratike të sektorit të sigurisë, si dhe adresimi i sfidave që dalin nga Plani Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimi -Asociimit, ku i referohet sektorit të sigurisë dhe fuqizimit të mbikëqyrjes demokratike të sektorit të sigurisë. Më tutje theksoi që edhe pse pjesa më e madhe e obligimeve që dalin nga Raporti i Progresit për Kosovën, si dhe nga Plani Kombëtar për MSA-në, i përkasin ekzekutivit që t'i përmbushi. Komisioni do të ndërmarri veprime mbikëqyrëse në realizimin dhe përmbushjen e këtyre sfidave të identifikuara në këto dy dokumente.

Po ashtu propozoi që të caktohet një referues nga radhët e Komisionit, i cili në vazhdimësi të përcjellë punën dhe kohë pas kohe të raportojë në Komision, në mënyrë që të jemi në rrjedha me çështjet dhe si janë duke shkuar. Më tutje propozoi z. Nuredin Ibishi që të jetë referues i këtij grupi punues.

Nuredin Ibishi- Propozoi që në përbërje të jenë tre anëtarë të Komisionit, duke marrë në konsideratë se ka mjaft çështje që duhet përcillen.

Kryesuesi- Propozoi z. Bojan Mitiq dhe znj. Ganimete Musliu që të jenë pjesë e këtij grupi punues.

Bojan Mitiq- Sa i përket këtij grupi, theksoi se nuk e di sa shpesh do të takohen por do të ketë përgjegjësi për këtë çështje. Prandaj propozoi që z. Qerim Bajrami të jetë pjesë e këtij grupi për të dhënë kontributin e tij.

Qerim Bajrami- Theksoi se pranon të jetë pjesë e grupit punues, por ka menduar që të jetë një përfaqësues i komuniteteve në këtë grup punues, siç është komuniteti serb.

Bojan Mitiq- Theksoi se mund të marrë pjesë në rastet kur mungon njëri nga anëtarët, pasi çështja që trajtohet ka të bëjë për të mirën e të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe të gjithë ne duhet të punojmë për këtë interes. Gjithashtu e gjithë ajo që do të punohet nga grupi punues, do të

vlerësohet në Komision, dhe se të gjithë ne do të punojmë në këtë drejtim. Nga ana juaj mund të njoftohem, dhe sa herë që të ketë nevojë mund të marrë pjesë në takimet e grupit punues.

Kryesuesi- Theksoi se puna në këtë grup nuk do të marrë shumë kohë, pasi edhe Komisioni do të jetë në përcjellje të kësaj çështje, por qëllimi ishte që të kemi anëtarë të Komisionit që janë duke u marrë me këtë çështje.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës me vota unanime nxori këtë:

VENDIM

Formohet grupi punues për trajtimin e sfidave që dalin nga raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2015 dhe nga Plani Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit me këtë përbërje: Nuredin Ibishi-kryesues, ndërsa Ganimete Musliu, Qerim Bajrami dhe Bojan Mitiq-anëtarë.

4. Të ndryshme

Kryesuesi- Në këtë pikë propozoi që bazuar edhe në planin e punës, duke pasur parasysh edhe çështjet e sigurisë të vendit dhe zhvillimet që kanë ndodhur në qendrat evropiane, gjatë muajit prill të ftohet për raportim në Komision Ministrin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrin e Ministrisë së FSK-së.

Nuredin Ibishi- Shtoi se duke analizuar situatën e sigurisë e cila është duke ndodhur me veprime terroriste në disa vende të rajonit dhe botës, theksoi se është e nevojshme të ftohen institucionet përgjegjëse të sigurisë, që të na bëjnë me dije aktivitetet e ndërmarra nga ana e tyre në parandalimin e veprimeve ekstremiste që qojnë në terrorizëm, me qëllim të parandalimit të veprimeve terroriste.

Kryesuesi- Theksoi se pajtohet me çështjet e propozuara që të jenë temë e raportimit të Ministrit dhe se si Komision do të informohemi për të gjitha çështjet që janë shqetësim i yni dhe i gjithë shoqërisë. Fillimisht në raportim do të ftohet Ministri i Punëve të Brendshme dhe më pas Ministri i Ministrisë së FSK-së.

Më tutje theksoi se si Komision do të vazhdojmë me aktivitete mbikëqyrëse edhe për Këshillin e Sigurisë Kombëtare dhe se në ditët në vazhdim do të planifikohen takime dhe aktivitete mbikëqyrëse.

Qerim Bajrami- Kërkoj që gjatë raportimit të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të informohemi edhe për çështjen e integritetit të pjesëtarëve të komunitetit pakicë në veri të vendit, pasi ka shumë ankesa nga komuniteti boshnjak për këtë çështje.

Kryesuesi- Sa i përket çështjes së propozuar nga ana e z. Qerim Bajrami theksoi se kur të ftohet ministri për të raportuar në Komision, mund të shtrohen pyetjet dhe se mund të adresohet si kërkesë në ftesën drejtuar ministrit.

Ganimete Musliu- Propozoi që gjatë muajit prill të realizohet një vizitë pune në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, në mënyrë që të shihen aktivitetet e tyre.

Qerim Bajrami- Lidhur me vizitat e Komisionit në vizita jashtë vendit, theksoi që të ndërmerren veprimet për vizitën e planifikuar në Turqi, për të vizituar komisionin homolog në Parlamentin e Turqisë.

Kryesuesi- Nëse nuk ka çështje të tjera për të ngritur, e konsideroj mbledhjen e mbyllur.

Me këtë pikë të rendit të ditës, mbledhjen e konsideroi të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetari i parë i Komisionit,

Fadil Demaku